



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE**  
**KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 18985 Prot

Vlorë, më 21.11 2024

**Lënda:** Njoftim për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, datë 27 Nëntor 2024.

**ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE**

**Për dajeni: KRYETARIT TË BASHKISË VLORE**

**PREFEKTIT TË QARKUT VLORE**

Ju njoftoj se, **ditën e Mërkurë , datë 27.11.2024, ora 10:00**, në Pallatin e Kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryesia e Këshillit, në bazë të ligjit nr. 139/2015, neni 53 pika 4, ku pas pikave;

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, datë 21.10.2024 dhe datë 28.10.2024.
2. Shprehje për ligjshmërinë e Vendimeve të Këshillit të Bashkisë Nr 92-95, datë 28.10.2024.

Do të vazhdojmë me këtë rend dite:

1. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë, për muajin tetor 2024”.
2. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për muajin tetor 2024”.
3. Projektvendim “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së zotit Luan Skëndaj dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.
4. Projektvendim “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së zotit Ëngjëll Memaj dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.

5. Projektvendim “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së zotit Nuro Blushaj dhe shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.
6. Projektvendim “ Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2025”.
7. Projektvendim “Për shprehjen e dakortësisë për nisjen e procedurave për transferimin në pronësi të Bashkisë Vlorë, të Pasurive Nr 36/179, Sipërfaqe 317,98m<sup>2</sup>, ZK 8602, Pasurisë Nr 36/76, Sipërfaqe 832, 4m<sup>2</sup>, ZK 8602, Pasurisë Nr 32/107, Sipërfaqe 390m<sup>2</sup>, ZK 8604, Pasurisë Nr 32/524/1, Sipërfaqe totale 552m<sup>2</sup>, ZK 8604, Pasurisë Nr 32/399, Sipërfaqe 32833m<sup>2</sup>, ZK 8604, Pasurisë Nr 32/106, Sipërfaqe 390m<sup>2</sup>, ZK 8604”.
8. Projektvendim “Për miratimin e kërkesës për shpenzime , për ushtrimin e funksionit të Këshillit të Bashkisë Vlorë, për vitin 2025 “.
9. Projektvendim “Për Miratimin e Programit të Punës së Aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Vlorë, për periudhën janar – dhjetor 2025”.
10. Projektvendim, “Për emërtim sheshi me emrin Ali Asllani” në territorin e Bashkisë Vlorë.
11. Projektvendim, “Për emërtim sheshi me emrin Bejkush Birçe” në territorin e Bashkisë Vlorë”.
12. Të Ndryshme.

Komisionet e përhershme, do të mbledhen në mjediset e Bashkisë Vlorë, si më poshtë :  
**Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike**, do të mbledhet ditën e hënë, datë 25.11.2024, ora 10:00.

**Komisioni për çështjet e ekonomisë, financave dhe privatizimet**, do të mbledhet ditën e hënë , datë 25.11.2024, ora 11:00.

V.O. Bazuar në rendin e ditës të sipërcituar, nëse ndonjë nga Komisionet e Përhershme, vlerëson se, duhet të mbledhet për çështjet që trajtojnë projektvendimet, Kryetari i Komisionit të njoftojë anëtarët e komisionit përkatës, për datën dhe orën e mbledhjes.

**KRYETAR**

**Elpiniqi Mërkuri**

**ME URDHËR DELEGIMI**

**NËNKRYETAR**

**Novrus Rrokaj**



Adresa: Sheshi “4. Dhronjtë”,: [www.vlora.gov.al](http://www.vlora.gov.al); E-mail: [info@vlora.gov.al](mailto:info@vlora.gov.al)